

ROVENA VATA

BESËTYTNIA ELEMENT MBIZOTËRUES NË RRËFENJAT E KUTELIT

Kuteli nuk rrëfen ngjarjen, por rrëfen rrëfimin për ngjarjen. Prandaj, autori merr rolin e ndërmjetësuesit në rrëfim në raport me dëgjuesin apo lexuesin. Ndërhyrjet e shpeshta autoriale në rrëfim, duke iu drejtuar lexuesit, nuk janë vetëm thirrje për ta bërë ngjarjen të lexueshme, por edhe për t'ia dhënë ngjyrën e vet kësaj ngjarje. Kështu autori merr një rol të ngjashëm me interpretuesin e këngës, veprës popullore¹.

Në literaturën shqiptare, krahas fjalës *legjendë*² përdoret edhe emërtimi *gojëdhënë*, çka shpreh më mirë diçka nga thelbi i saj, faktin që “*jepet me gojë*”; në gjermanisht legjenda thërritet *sag*, por s’ka të bëjë fare me sagat skandinave. Kjo fjalë vjen nga latinishtja, legjenda, që do të thotë “*diçka që është për t’u lexuar*”. Kuptimi burimor i legjendës të çon te mësimet apo predikimet e shërbesave fetare, si dhe te leximet e murgjive mbi jetën e shenjtë të ditës, apo përgjithësisht për jetën e shenjtorëve, jeta e të cilëve lexohej gjatë vakteve, ndër manastiret.

Por në gjysmën e parë të shekullit XX u mësua se, ka një ndryshim ndërmjet legjendave dhe rrëfimeve të shenjta.

Bota e legjendave fqinjëron me botën e miteve, me atë të poezisë popullore epike dhe me atë të përrallave, pavarësisht se është vështirë të saktësosh kufijtë midis tyre, e aq më shumë të gjesh kujt i përket mosha më e hershme. Studiuesit V. Vund dhe H. Gunkel kanë shprehur pikëpamjen se, zanafilla e universit të këtyre gjinive të përafërta nuk janë mitet, siç ishte menduar për një kohë të gjatë, por përrallat. Legjenda dallohet nga miti, nga fakti se ajo nuk ka përherë një domethënie simbolike, nuk përçon përherë diçka thelbësore për natyrën njerëzore.

Legjendat janë kallëzime popullore, që shpjegon krijimin e botës, të universit e të njeriut, të botës bimore e shtazore, të vendbanimeve, si dhe për një ngjarje të së kaluarës, për një figurë historike, etj., që mund të ketë

¹ S. Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, UET/Press, Tiranë, 2009, f. 359.

² T. Çaushti, *Fjalori i estetikës*, Ombra, Tiranë, 2005, f. 227.

një bazë të vërtetë, por që është shtuar e zbukuruar nga fantazia popullore dhe përcillet gojë më gojë, nga një brez në tjetrin.

Lugetërit janë figura mitologjike, që trajtohen dendur në prozën e Mitrush Kutelit. Veprimet e lugetërve në prozën e tij i konkretizojnë situatat e ndonjëherë ata shkaktojnë kaos të paparë, mu si djajt³.

Te rrëfenjat e Kutelit si: *“Fije nga jeta e Theofil Kostorit”*, *“Lugetërit e fshatit tim”*, *“Fshati im e pi rakinë”*, ku më tepër zë vend përshkrimi i jetës fshatare shqiptare me mentalitetet, paragjykimet, besëtytnitë dhe natyrën e mrekullueshme të saj⁴.

Tregimi: *“Kryengritje për lugat”* është ngritur mbi një truall të veçantë idesh dhe projeksionesh sociale, në rrënjë të cilave janë besëtytnitë dhe besimet religjioze pagane e mbaspagane në lugetërit dhe misionet e tyre shkatërrimtare.

Figura e lugatit, e hijeve të bardha, nuk perceptohet në funksionin e vrasësit, mbytësit të njerëzve, por është vetëm prani fizike një ballafaqim qëllimor me të gjallin (ecën i gjalli me të vdekurin, si në baladat e besnikërisë)⁵.

Një ndër figurat e rëndësishme mitologjike, ndër ne dhe ndër fqinjët tanë, ka qenë edhe lugati, megjithëse ai paraqitej shumë më rrallë se shtriga në këto vise. Mirëpo, frika që shkaktohej nga shtriga; kjo për arsye se lugati vinte nga një botë tjetër, e panjohur dhe misterioze, vinte nga terri i varrit, ishte i padukshëm; kështu që fantazia e njeriut në lidhje me të, kishte fushë të gjerë për të krijuar paragjykime dhe besime të kota pa kufi⁶.

Bestytania si një nga format e vjetra të projektimit të botës dhe të të vërtetave jetësore, këtu është intertekstualizuar dhe fuqizuar në përmasën e një realiteti *“të verifikueshëm”*: *“Që kur i doli të birit të Qipros fjala se beson lugat, humbi nderë e dashurinë e fshatit, si në turq e në kaurë. Jo vetëm se s’ka njeri që ai kthen mirmëngjesin, jo vetëm se i thonë mason e papiston, po ia paskan ngjitur se nga pun’e e tij - që s’beson lugat!-*

³ Rr. Berisha, *Subjekte mitologjike në rrëfimet e Mitrush Kutelit*, në: “Kënga-art dhe histori”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998, f. 162.

⁴ M. Meminaj, *Veçori të metodës krijuese në prozën e Mitrush Kutelit*, Maluka, Tiranë, 2005, f. 39.

⁵ S. Bashota, *“Netët Shqiptare” të Mitrush Kutelit*, në: “Filologjia”, nr. 5, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 1998, f. 226.

⁶ M. Krasniqi, *Lugati në mitologjinë tonë*, në: “Gjurmime albanologjike”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, folklor dhe etnologji, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1995, f. 47.

perëndia i punon fshatit kaq alamete e valoma. Bie shi shumë e vjen Lumi i Madh; fajin e ka çuni i Qipros! Nuk bie shi e thahet misri; fajin e ka çun' i Qipros! U bie gëlbaza dhenve; fajin gjithë çuni i Qipros! E gjithë çuni i Qipros e ka fajin se u bie hiri vreshtave, se ikën peshku nga kufiret tona e se i hyri krimbi arrës së Banushit. E jo vetëm kaq, po i paska dalë fjala se valla ha bukë me të madhë e shejtan”⁷.

Siç mund të shihet nga fillimi i rrëfimit, i tërë tregimi ngrihet mbi një realitet etnologjik. Vetë ky realitet paraqet intertekstin bazë mbi të cilin ndërtohet tragjedia e personazhit që quhet Çuni i Qipros, i cili i vë në dyshim principet e këtij realiteti besëtytnor. Si struktura narrative, ashtu edhe vetë intriga e vetë tregimit është e lidhur me mosbesimin e Çunit të Qipros në lugat, që për fshatin, për realitetin mendor e shpirtëror të tij, paraqet njëherazi të padëgjuar, për të cilin zoti ndëshkon njerëzit, gjënë e gjallë të tyre, pemët dhe të lashtat. Brenda kësaj intrige, ka ndodhur një dramë, me vetë shfaqjen e mosbesimit të të birit të Qipros. Konflikti i këtushëm dramatik, rrjedh edhe si konflikt diskursiv e moral, po edhe si konfrontim ideologjik. Shenjat e mitosit, si një diskurs oral etnologjik, janë ndeshur fuqishëm me shenjat e një projekti vetjak të botës e jetës, që paraqet një diskurs personal, metafizik, të personazhit. Ndeshja e këtyre diskurseve është e fuqishme sikurse që është edhe loja e tyre e rrjedhshme si gjuhë.

Tregimi: “*Lugetërit e fshatit tonë*” paraqet një seri rrëfimesh të lidhura në një temë, me një tip personazhi dhe me një tip situatash të ngjashme, që të gjitha të lidhura me lugat. E tërë baza e rrëfimit dhe e situatave është popullore dhe në të vërtetë, interteksti oral në këtë rast përbën vetë tekstin.

“Vjet kemi pasur lugat të fortë Shaqon e Shabanit, njëviti një tjetër që u bë edhe kanxhalloz edhe sivjet Meron e Cutes. Ky murgu Mero ra e vdiq aty e dy muaj nga njëfarë ograie, se i pat qenë shkruar. Që në të gjallë fshati thosh se do ngrihet lugat. E me të vërtetë, sapo vdiq, ra e u ngrit”⁸.

Ky projeksion i rrjedhës së kohës, ka të ngjarë që është një intertekst-koment autorial, i ndërkallur në gojën e personazhit i cili flet dhe vepron si aktant i një strukture të tërë narrative, kompozicionale e semantike orale. Mbi ndërtime të tilla miniaturale, qoftë në këtë bosht tematik, qoftë në boshte të tjera, mund të hasim edhe në ndonjë pjesë tjetër

⁷ M. Kuteli, tregimi: “Kryengritje për lugat”, në: *Netë Shqiptare*, Naim Frashëri, Tiranë, 1938, f. 199.

⁸ M. Kuteli, tregimi: “Lugetërit e fshatit tonë”, në: *Netë Shqiptare*, Naim Frashëri, Tiranë, 1938, f. 295.

të tregimit. Me një fjalë, Kuteli në mes rreshtave shpërthen si ide, ndërsa në rrafshin e sintagmës si gjuhë; formë këto të ndryshme të ndajvëna mbi gjedhen narrative e tematike orale.

Krijimtaria popullore i ka përfytyruar kurdoherë qeniet mbinjerëzore si pjesëmarrëse në jetën e përditshme të njeriut, që bashkëveprojnë me njeriun, e ndihmojnë ose e pengojnë atë.

Një vend të veçantë në rrëfenjat e Kutelit për sa i përket besëtytnisë si element mbizotërues, janë edhe figurat e djajve, shtrigave.

Ekzistenca e profilit të gruas së ligë shprehet vetëm përmes gojëdhënave apo rrëfimeve të personave të cilët pretendojnë se i kanë parë ato, duke bërë magji. Profili “shtrigë” një figurë imagjinare, asnjëherë e verifikuar, por e përshkruar si një qenie njerëzore, me sjellje jo normale, me mendësi të mbrapshtë dhe e prirur vetëm për të bërë të këqija, qenie e cila ka mungesë të ndjenjës njerëzore, humane dhe shoqërore. Figura e “shtrigës”, në të gjitha mitet, gojëdhënat, përshkruhet si fizik njerëzorë, me flokë të shpupuritur të palara, thonj të mëdhenjtë, sy të çakërdisur dhe e leckosur, e cila jeton në të shumtën e rasteve në shpella të errëta, në përroje e male në shoqërim të lakuriqëve dhe minjve, por ritualet për bëmat e këqija sipas gojëdhënave shtrigat i kanë kryer në varreza gjithmonë e zhveshur ‘lakuriq’ gjatë ritualeve dhe punëve të saj⁹.

E përbashkëta e paraqitjeve që përftojnë besëtytni është vegimi. Psikologjia i lidh ato me një aftësi të përgjithshme, me imagjinatën.

*“Të dytën ditë ime gjyshe më shoqti thëngjij në ujë të panisur e më dha të pi. Thëngjijtë ishin mbi ujë. Gjithë asaj ditë ka shuar një patkua kali, të skuqur në zjarr, në ujë të rrahur, të marrë me natë nga penda e mullirit, në udhë të paprerë. Më ka qepur pastaj në fermele një hajmali të shkruar prej hoxhës së xhindeve. Nuk e di cila nga këto zuri, po dalngadalë, u bëra mirë. Kam kërkuar pastaj lakruar të athët me lëmpjetë mali edhe kam filluar të ysht botën, me tri fije fshesë e pak kripë, si pata parë Milkën”*¹⁰.

Hofmani besonte se forcat demoniake, të errëta, shkatërruese, keqbërëse kanë një shtrirje të pakufizuar dhe e përcaktojnë për keq lojën e historisë e të fatit të njeriut. Sipas tij këto forca veprojnë, jo vetëm së jashtmi mbi njeriun, por shpesh edhe së brendshmi, gjallërohen në shpirtin e tij¹¹.

⁹ J. Hajrullahu & I. Kelmendi-Shema, *Profili i gruas së ligë (shtrigës) në kulturën shqiptare-vështrim antropologjik*, në: “Java e Shkencës”, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Departamenti i Shkencave dhe i Teknologjisë, kumtesat I, shkencat gjuhësore, kulturore dhe historike, Prishtinë, 2013, f. 301.

¹⁰ M. Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990, f. 85.

¹¹ A. Uçi, *Mitologjia, folklori, letërsia*, Naim Frashëri, Tiranë, 1982, f. 138.

Një pjesë e tregimeve të Kutelit pasqyrojnë zakonet, jetën e përditshme të fshatit si të *“Fije nga jeta e Theofil Kostorit”*. Rrëfenjat janë të dallueshme jo vetëm nga brendia, por edhe nga trajta e rrëfimit të tyre dhe mënyra e ndërtimit. Përmendim këtu: *“Hanet e karvanet”*, *“Rinë Katerinëza”*, *“Natë marsi”*, *“Natë gushti”*, ku autori përshkruan jetën shpirtërore shqiptare, në mënyrë të ngjashme me mënyrën e thurjes së rrëfenjave popullore. Këtu, mbështetja në folklor, është më e spikatur e për rrjedhojë edhe elementët mitologjike janë më të dukshëm se në rrëfimet e tjera.

Kështu lugetërit u shfaqen njerëzve dhe i trembin a i sëmurin, njerëzit kërkojnë thesare të fshehta në shpella të frikshme, ku u shfaqen qenie jo të kësaj bote, të vdekurit marrin pjesë në gosti, të gjallët vizitojnë botën e të vdekurve, martohen mes tyre dhe lindin fëmijë, njerëzit yshten për t'u mbrojtur nga syri i lig e magjitë, festojnë festa e kryejnë rituale pagane, rrëmbehen nga zanat. Duket se në krijimet e këtij realiteti, të kësaj bote, Kuteli është joshur nga mitologjia e vendit të tij, ashtu si shkrimtarët e realizmit magjik u joshën nga mitologjitë e vendeve të tyre, duke krijuar në veprat e tyre realitete, ku ashtu si në botën e mitologjisë, thyhet dallimi mes reales e irreales, mes të besueshmes e të pabesueshmes, e ku kërshëria për të njohur botën, për të kuptuar realitetin, i jepte forcë fantazisë, që të thurte krijesat e saj, që për njerëzit ishin edhe udhërrëfyese në udhën e të fshehtave, edhe mistere që nuk do të zbuloheshin kurrë.

Për këtë Northrop Fraj në një studim të tij për mitin shprehet: *“Në botën e mitit nuk kemi përshtatjen ndaj përvojës së njohur. Miti është imitim i veprimeve afër ose brenda kufijve të mundshëm të dëshirës”*¹².

Lidhja e shkrimtarit me mitologjinë nuk është një lidhje e sajuar me mund, por një lidhje që vjen natyrshëm, për të cilën nuk është e nevojshme të studiosh thellësisht ç'është miti më tepër se ç'është e nevojshme të dëgjosh e të kapësh me intuitë atë që s'mbetet thjesht problem i një kohe, por i të gjitha kohërave, atë që edhe pse shekujt i kanë kaluar sipër, ende mbetet si pikëpyetje në ndërgjegjen e njerëzimit. Lidhjen mes mitit dhe shoqërisë njerëzore e mbështete edhe Zigmund Frojdi kur citon Otto Rank, sipas të cilit: *“Mitet janë projektuar drejt qiellit pasi kanë lindur diku në kushte ekskluzivisht njerëzore. Interesi ynë drejtohet pikërisht te kjo përmbajtje njerëzore”*¹³. *“Përse këto dyfeqe! - kini për të pyetur ju, o të mirë. Që t'i prishet magjia bagëtisë e t'i largohen të ligat. E gjithë këta korrozinj e këta korrozeza vinin e mbushnin ujë të rrahur në tre mullinj,*

¹² N. Fraj, *Anatomia e Kritikës*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 188.

¹³ Z. Freudi, *Psikoanaliza e artit dhe e letërsisë*, Dituria, Tiranë, 2000, f. 92.

*hidhnin brenda trëndafilë e lule të tjera edhe laheshin që të prishin magjitë*¹⁴.

Një figurë tjetër e demonologjisë, e cila mbizotëron në krijimtarinë e shkrimtarëve në studim, është edhe *Vampiri*, i cili quhet dhe *Dhampiri*, është i biri i *Lugatit*. Besohet se njeriu që ngrihet lugat, shkon e fle me gruan e tij, ajo mbetet shtatëzënë dhe lind *Vampiri*, që di të vrasë lugatin që dëmton bagëtinë¹⁵.

Për ta zbërthyer besimin për *“ngjizjen me burrin e vdekur”*, dhe lindjen e atij fëmije do të shërbehemi me mendimin e Franz Boas i cili thotë: *“Pas vdekjes së njeriut të dashur, si njeriu primitiv ashtu edhe ne spekulojmë me mendimin se çka mund të ketë ndodhur me shpirtin e tij dhe njëkohësisht kemi një dëshirë të zjarrtë të zhbëjmë vdekjen dhe ta kthejmë në jetë. Dëshira e zjarrtë e shtyen imagjinatën që gjithçka dhe gjithkush të na ngjajë në të”*¹⁶.

Në lidhje me këtë që thamë më lart Kuteli shkruan: *“S’është punë e paktë të kesh lugatin për burrë! Kur erdhi Zefi e s’e gjeti, u egërsua fort e mend i vuri zjarrë fshatit. I ra hoxhës me topuz, i ra priftit me kamxhik, i ra qefalisë me shul të veglës. Donte gruan i shkreti! E dinte edhe ai vetë ku ndodhej, po në Shëndaum nuk hynte dot. Tashi rrinte edhe priste në shtëpi, të vijë prapë. Mbyllur dritaret me merimanga, rrinte natë për natë gjersa këndontë këndesi i parë”*¹⁷.

Sipas shkollës antropologjike: *“Prodhimet e para të folklorit lindën bashkë me njeriun. Këto rituale i lindi nevoja e njeriut të vjetër. Pra ky njeri nuk ndërtoi marrëdhënie estetike me botën, por këtë ndërtim e vuri në shërbim të nevojave të tij, pra prodhimet e para folklorike janë të lidhura ngushtë me magjinë, religjionin”*¹⁸. Ndërkaq, Kuteli shpjegon kështu: *“Ky djalë të ka rënë më sy, i thanë së mjerës nënë. Ja, shikoja synë, si i ndrit e sa të madh e ka, sa një filxhan. Thirr Milkën të ta yshtë. Për të yshtur dinte edhe ime gjyshe, - po ja, asaj nuk i zirej se më kish gjak”*¹⁹.

¹⁴ M. Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990, f. 90.

¹⁵ M. Tirta, *Mitologjia ndër shqiptare*, Mësonjëtorja, Tiranë, 2004, f. 231.

¹⁶ A. Dushi, *Miti dhe rrëfimi gojor personal*, në: *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 2006, f. 375.

¹⁷ M. Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990, f. 314.

¹⁸ A. Jakllari, *Historia e mendimit etnologjik*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2003, f. 62.

¹⁹ M. Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990, f. 82.

Sipas Kostandin Brenuas: “*Arti popullor është çlirim magjik, përcjellës i normave etike, lirim i fuqive kozmike, përbetim i demonëve, procese kulti, pjesë e pandashme e jetës së përditshme*”²⁰.

Kuteli shprehet në këtë mënyrë: “*Bota thosh edhe se ime gjyshe e kish synë kaq të fortë, sa e rrëzonte kalorin nga kali, mbante në vend gurin e mullirit dhe e bënte të plaste copë-copë. Vetëm me një të shikuar!*”²¹.

Në rrëfenjat e Kutelit zë vend të konsiderueshëm figura e *Lugatit*, kjo figurë sipas Robert Elsie është figurë në mitologjinë shqiptare. Kjo krijesë si vampir është me prejardhje sllave. Kur një i lig, koprrac ose matrapaz vdes dhe varroset, ai mund të kthehet në *lugat*. Ashtu si *larvae-t* dhe *lemure-t* e Romës së lashtë, *lugetërit* ngrihen nga varri çdo natë, përveç të shtunës, shkojnë te shtëpitë e të afërmeve dhe të të njohurve, u thyjnë xhamat e dritareve, u përdhunojnë gratë dhe përgjithësisht bëhen të bezdisshëm.

Ja një shembull përshkrimi tipik i Kutelit: “*Që asaj nate i ka hyrë lugati në qymez të pulave e u ka kthyer kokën të gjithave. Të dytën natë u sëmure dhitë. Të tretën natë mori zjarr shtëpia. Xëme, kjo! E kish inatin të fortë, si inat lugati!*”²².

Tërësia e veprimtarive dhe e qëndrimeve praktike rituale, që lidhen me besimin e njeriut primitiv, në mundësinë për të ndikuar në forcat e natyrës me ndihmën e disa forcave të mbinatyrshe praktikoheshin për të triumfuar e mira mbi të keqen, si dhe për ta mundur këtë të fundit. Mënyra karakteristike e bërjes magji, me anën e shprehjeve dhe shembujve, me anën e thirrjeve dhe shtirjeve (për shembull, derdhja e ujit për të bërë që të bjerë shi, etj.) i japin magjisë njëfarë analogjie me estetikën²³.

Një efekt të fortë të intertekstit oral në prozën e Kutelit, paraqesin disa përftesa a performanca që përgjithësisht mund të përmbliken si skenike, por që në vete kanë edhe elemente narrative apo ndonjë shkëndijë lirike. E tillë është prania e magjive, ritualeve magjike dhe e formulave përgjithësisht, qoftë me krijimin e situatave nëpër të cilat sprovohen personazhet, qoftë si sforcime idesh e refleksesh ideore, emocionale e mistike, skenat me *lugetër*, me vajtime e mallkime.

Disa elemente të përmendura janë mjaft të pranishme në tregimin: “*Fije nga jeta e Theofil Kostorit*” të Kutelit. Aty rituali i konstatimit, por edhe i fillimit i shprishjes së magjisë apo edhe i yshtjes së mësyshit, nis me

²⁰ A. Jakllari, *Historia e mendimit etnologjik*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2003, f. 63.

²¹ M. Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990, f. 130.

²² M. Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naim Frashëri, Tiranë, 1990, f. 310.

²³ T. Çausi, *Fjalori i Estetikës*, Ombra, Tiranë, 2005, f. 234.

një skenë të tillë: *“Gjer të vijë Milka, nëna me lau me gur Shërmarene. Gur i Shërmarenes ish një copë çmërs, me vrima shumë, i marrë nga shpella e zonjës Shërmarenë. Nëna e mbante aty ne kora. Kur bija me sy, mbushte një misur me ujë, bënte mbi të kryq edhe e hidhte brenda e me jepte të pi. Po të bëheshin sumbulla, ish një me një se kisha rënë me sy. E sumbulla u patën bërë këtë radhë shumë!- I plastë syri kush e ka të keq!”*²⁴.

Ky ritual verifikues për marrjen mësysh edhe njëkohësisht edhe parandalues, është një intertekst i gjallë i fëmijërisë së personazhit, të cilën ai e rrëfen në trajtë kujtimi. M’u për këtë, diskursi mitik që lidhet me ritualet, në tekst, nuk paraqet mëvetësi internacionale diskursive, çfarë mund të ndodhë në rastet kur ritualet janë parabola simbolike e narrative thellësisht fiktive. Këtu rituali është dhënë si jetë, siç vazhdon edhe me tutje: *“-Dal, moj t’ia nxjerrim të ligën, t’ia hedhim në lumë, ta hajë peshku. Ma sill njat fshesë të marr dy-tri fije, me jep e ca kripë e ta bëjmë flij këtë djalë. U ngrit nëna, vajti në kripsi mori kripë, vajti ne dera mori tri fije fshesë e ia solli. Ka moj, motër, në këtë botë, ca sypëgërë e syplasje që jarebi! Mos arrifshin të shohin më u plastë të bardhët, u plastë!”*²⁵.

Tashmë rituali antimagji është bërë intertekst i kuptimeve e botëkuptimeve jetësore të personazhit të këtij rrëfimi. Rituali është mënyrë jete, e afrimit dhe e ruajtjes së vlerave. Si i tillë, çdo ritual magjie e antimagjie, është dhe një lloj përshkrimi, meqë nuk paraqet kreacion në kuptimin e fiktivës letrare sa paraqet një intim narratorial.

*“Kur sos buzë kroit që t’i japë kalit ujë, na sheh aty tri orë të bardha tek lodrojnë në dritën e hënës. Orët llamburisin. Herë duken si nuse të bardha, herë si lule të bardha”*²⁶.

Kuteli sprovon të fusë një pjesë të gjuhës së tij personale si përshkrim e karakterizim të situatave e personazheve, por në esencë mbetet paramodelit boshti kryesor në të cilin ngjiten elementet përbërëse të rrëfimit.

Ata njerëz që ndërtojnë shtëpi në tokën e shtojzovallës nuk gjejnë rehat, sepse shtojzovallja u vjen në shtëpi në mes të natës dhe kërcet zinxhirë të rëndë prej hekuri. Njerëzve u thuhet të mos dalin në rrugë në diellin e mesditës, sepse mund të shkelin në shtojzovallë e të gëlltiten prej saj.

²⁴ M. Kuteli, tregimi: “Fije nga jeta e Theofil Kostorit”, në: *Vepra letrare 2*, Naïm Frashëri, Tiranë, 1990, f. 70.

²⁵ M. Kuteli, *Vepra letrare 2*, Naïm Frashëri, Tiranë, 1990, f. 78.

²⁶ M. Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare*, Mitrush Kuteli, Tiranë, 2005, f. 99.